

# EC

MA NDRYSHE

# EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -



## EKO KLUBI

## "LASGUSH PORADECI"

# 3




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development

## CARITAS

Schweiz  
Suisse  
Svizzera  
Svizra

## YENI

YOUTH  
ENVIRONMENTAL  
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e tretë e buletineve mjedisore të eko-klubevetë shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i IAAP "Lasgush Poradeci" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

# SHTERRIMI I LUMENJVE, PASOJË E

## NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Ujërat e rrjedhshëm kanë një rol unik në mbështetjen e biodiversitetit global, cikleve bio-gjeokimike dhe jetës njerëzore. Megjithëse rëndësia e tyre është e mirëpranuar, vlera dhe fati i lumenjve/përrenjve që preken nga pasojat e tharjes së shpeshtë të tyre, priret të neglizhohet. Tharja e lumenjve kontribuon në degradimin e burimit kryesor të ujit, për rrjedhojë në jetesën e miliona njerëzve.

Kjo problematikë, të cilën e ndeshim në çdo skaj të globit, veçanërisht këto vitet e fundit ku efekti i ndryshimeve klimatike sa vjen e bëhet më i dukshëm, është objekti i analizës së një studimi të botuar në revistën shkencore “Science”.

Një grup studiuesish nga Universiteti McGill në Kanada, analizuan të dhënat e përftuara prej stacioneve të vendosura në 5600 lumenj. Në këto stacione, u mat sasia e prurjeve të ujit të rrjedhët dhe më pas, u llogarit probabiliteti i ndalimit të rrjedhjes. Për llogaritjet, u përdorën të dhëna klimatike, gjeologjike dhe të faktorëve të tjerë mjedisorë.

Përfundimet treguan se, më shumë se gjysma e lumenjve në Botë reshtin së rrjedhuri, të paktën një herë në vit. Konkretisht, janë 60% e lumenjve të botës, që shterojnë për të paktën 1 ditë në vit dhe arsyet kryesore të këtij fenomeni, lidhen me ndryshimet klimatike.



# SHTERRIMI I LUMENJVE, PASOJË E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Në të ardhmen, me rritjen në vazhdim të këtyre pasojave, lumenjtë do të vijojnë të shterojnë duke rrezikuar jetesën e miliona njerëzve që e përdorin lumin për ujitje dhe nevoja të tjera jetësore. Për rrjedhojë ndryshimi i sistemit lumor do të ndikojë edhe në biodiversitetin e vendeve ku ndodhen lumenjtë.

Studimi i shërben planifikimit dhe marrjes së masave për menaxhimin e burimeve ujore, në përballimin e krizës së pritshme të tyre.

Për shkak të situatës jo të favorshme në të cilën ndodhen lumenjtë vendas dhe ata botërorë, lind nevoja për hartimin e planeve dhe vendimmarrjeve në dobi të tyre si dhe për komunitetet që jetojnë aty pranë.



# BIFURKACIONI

Bifurkacioni (Bigëzimi) është fenomen natyror kur një lum ndahet në dy degë dhe derdhet në ujëmbledhësa të ndryshëm detar. Bifurkacioni i lumit konsiderohet të jetë një fenomen artificial, por i krijuar në kushte shumë të favorshme natyrore. Njihen vetëm dy raste të tilla. Njëri rast është në Kosovë ku lumi Nerodime ndahet në dy degë. Nerodimja pra është me rëndësi të veçantë për hidrografinë e Kosovës sepse përfaqëson shembullin e vetëm të Evropës të një bifurkacioni lumor që rrjedh në dy detet, Detin e Zi dhe Egje. Njëra i bashkohet lumit Lepenc i cili pastaj derdhet në lumin Vardar i cili përfundon në detin Egje dhe dega tjetër derdhet në lumin Sitnica e cila derdhet në lumin Ibër dhe pastaj përfundon në detin e Zi. Rasti tjetër i bifurkacionit paraqitet me lumin Orinoko në Venezuela.





# AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:


TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE OJQ  
EC MA NDRYSHE





# AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE OJQ  
EC MA NDRYSHE



# **EKO KLUBI "LASGUSH PORADECI"** **KIJEVË, MALISHEVË**

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe  
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,  
Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)

[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".